



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:092461
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05619047

AA.nr.174/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A. H., nga P., përfaqësuar nga avokat N.I., P., rr. "...", nr..., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përfaqësuar nga F. G., me bazën juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1073/2021, i datës 13.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit A. H., nga P., e datës 07.02.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1073/2021, i datës 13.01.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit A. H., - P., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës A.nr.... datë ..., pagesën bruto për pagën shtesë prej 49,000.00 (dyzet e nëntë mijë) euro në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin të përmbarrimit me dhunë sipas obligimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që ti përgjigjet paditësit lidhur me kërkesat financiare.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovojë ankesën e paditësit si të bazuar, ndërsa aktgjykimin A.nr.1073/2021 të datës 13.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë ta anuloj dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosije.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin A.nr...., të datës ..., në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.... e datës ..., e parashtruar nga ankuesi A. H.. Në pikën II. Mbetet në fuqi vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KOM/.... i datës

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në gjykatë, kundër të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, duke pretenduar se vendimi është jo ligjor, me propozimin që i njëjti të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesorë më datë 13.01.2023, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: Nga shkresat e lëndës vërehet se paditësi, kundër mos realizimit të shtesës në pagë, ankesën në komisionin për zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e ka parashtruar më datë 01.07.2019. Me vendimin e këtij komisioni i njëjti shpallet jo kompetent për të trajtuar ankesën e datës ... nr.... (kërkesë kjo e cila deklarohet si e parashtruar për kompensim edhe në ankesën e datë 29.07.2019 të këtu paditësit pranë KPMSHCK), kurse me vendimin e të paditurës KPMSHCK A.nr.... datë ..., është refuzuar ankesa e këtu paditësit e paraqitur kundër vendimit të Komisionit të lartcekur.

Gjykata konstaton se paditësi referuar deklarimeve të tij si në referatin e padisë pretendon se nga data 25.08.2014 me akt emërim është emëruar Udhëheqës i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike-MTI dhe se nga data 12.03.2014 e tutje është dashur që për çdo muaj të kem shtesën në të ardhura personale në vlerë prej 500 euro duke u bazuar në vendimin e datës 08.10.2008, në këtë kuptim Gjykata nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur asnjë kërkesë apo ankesë drejtuar punëdhënësit lidhur me pretendimet e tij për kompensim përveç ankesës së datës 01.07.2019 të referuar në vendimit të datës 25.07.2019 (kërkesë-ankesë kjo e deklaruar nga paditësi si e parashtruar edhe në deklaratimet e ankesës së datës 29.07.2019 parashtruar pranë KPMSHCK), e që në këtë kuptim po ashtu nga shkresat e lëndës Gjykata ka konstatuar listën e distribuimit-MTI të datës 15.10.2015-kërkesë për vazhdimin dhe plotësimin të shtesave nga MTI, në të cilën kërkesë referohet edhe akt emërim edhe për këtu paditësin, e cila kërkesë në shkresa të lëndës është e bashkangjitur si jo e aprovuar, andaj duke pasur parasysh komunikimet elektronike të bashkangjitur në shkresat e lëndës nga vetë paditësi Gjykata ka konstatuar se në komunikimin elektronik të datës 18.04.2016-Divizioni i Burimeve Njerëzore këtu paditësi njoftohet se lidhur me kërkesën dërguar MAP akoma nuk është marrë përgjigje. Në këtë kuptim Gjykata kishte parasysh se që nga periudha e njoftimit të këtu paditësit periudhë kjo e viti 2016, se nuk është pranuar përgjigje për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për aprovim të pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare bazuar në kriteret që duhen

përmbushur, paditësi kundër mos realizimit të shtesës ka parashtruar ankesë pranë komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave me datë 01.07.2019.

Gjykata konkludon se nga data e njoftimit datë kjo 18.04.2016 të këtu paditësit nga burimet njerëzore të MTI, se nuk ka përgjigje nga MAP/MF për aprovim të pozitive dhe shtesave për kategori të veçanta të profesioneve deficitare e deri në parashtrimin e ankesës në KZKA më datë 01.07.2019 (kërkesë-ankesë kjo e deklaruar si e parashtruar nga vete paditësi edhe në ankesën e datës 29.07.2019 parashtruar pranë KPMSHCK), konstaton se këtu paditësi ka lëshuar afatet për të realizuar kërkesën e tij.

Lidhur për bazën juridike gjykata e shkallës së parë iu referua neneve 130.1, neni 130.2 të Ligjit për Procedurën e Administrative, nenit 8.2 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurën për Zgjidhjet e Kontesteve dhe të Ankesave, nenit 7 paragrafi 1 dhe neni 319.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative .

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj në tërësi e aprovon edhe Kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e Vendimit të KPMSHCK, të atakuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Gjykata e Apelit njëjtë si gjykata e shkallës së parë, i aprovon si të drejta dhe ligjore. Kolegji i apelit e vlerëson si të drejt konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësi nuk ju ka përmbajtur afatit të paraparë me nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Administrative i cili përcakton se: *“130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi”*, për faktin se duke u bazuar në shkresat e lëndës vërehet se paditësi, me datë 25.08.2014 me akt emërim është emëruar Udhëheqës i Divizionit për TI dhe Shërbime Logjistike-MTI, ndërsa me datë 01.07.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ka ushtruar ankesë me të cilën ka kërkuar shtesat në të ardhura personale në vlerë prej 500 euro, për mos realizim të shtesës në pagë, nga data 12.03.2014 e tutje, duke u thirr në vendimin e Qeverisë nr.02/39 të datës 08.10.2008, pra ankesën e ka ushtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Në raport me pretendimin e paditësit “se nuk kemi të bëjmë fare me afat të parashkruar ngase i njëjti kërkesën e parë me shkrim e ka paraqitur me datë 16.06.2014, pastaj me radhë duke ju drejtuar të gjitha institucioneve relevante si dhe individëve përgjegjës në institucione përkatëse”, këtë pretendim kolegji e refuzoj si të pa bazuar për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë kërkesë apo ankesë drejtuar këtyre institucioneve brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike Kolegji konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit, në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse paditësi me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij,

ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, se ankesa nuk rezulton nga faktet e vërtetuara dhe provat e vlerësuara andaj thënieve të ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i Ligjit për procedurën kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.174/2023, datë 25.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi